

Haxhi Shabani

# LIBRI ËSHTË DIJE

LETËRSIA 5

Për klasën e pestë të shkollës fillore  
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore  
PODGORICË, 2020

Dr. Haxhi Shabani

## LIBRI ËSHTË DIJE

LETËRSIA 5

PËR KLASËN E PESTË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT

## KNJIGA JE ZNANJE

KNJIŽEVNOST 5

PRIRUČNIK ZA PETI RAZRED OSNOVNE ŠKOLE

**Botuesi:** *Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë*

**Për botuesin:** *Pavle Goranoviq*

**Kryeredaktor:** *Radulle Novoviq*

**Redaktor përgjegjës:** *Llazo Lekoviq*

**Redaktor i librit:** *Dimitrov Popoviq*

**Recensues:** *Dr. Mark Camaj  
Mr. Anton Gojçaj  
Nikolla Camaj  
Fran Vulaj  
Fatbardha Saraçi (Osmanaga)*

**Dizajni dhe faqosja:** *studio ZUNS*

**Korrektor:** *Dimitrov Popoviq*

**Redaktore teknike:** *Dajana Vukçeviq*

CIP – Каталогизација у публикацији  
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2384-3

COBISS.CG-ID 17049348

Këshilli Kombëtar i Arsimit me vendimin nr. 10903-119/20-3335/13 të datës 24. 07. 2020  
e miratoi këtë komplet të Tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2020

# PËRMBAJTJA

<b>KREU I: ËMBËL DHE BUKUR NË GJUHËN SHQIPE . . . . .</b>	<b>7</b>
Naim Frashëri: BILBILI . . . . .	8
Ndre Mjeda: GJUHA SHQIPE . . . . .	9
Odhise Grillo: MOLLËKUQJA E FËMIJËRISË . . . . .	10
Sami Frashëri: SOLONI DHE KRISUA . . . . .	11
Mitrush Kuteli: ROZAFATI . . . . .	12
<b>KREU II: LIBRI, USHQIM I SHPIRTIT . . . . .</b>	<b>13</b>
Filip Shiroka: LULES QË M' DËRGOI NANA E EME . . . . .	14
Aleks Stavre Drenova: VJESHTA . . . . .	15
Faik Konica: BORA . . . . .	16
Kiço Blushi: BENI ECËN VETË . . . . .	17
Huan L. Davi: ME GJITHË SHPIRT . . . . .	18
<b>KREU III: YJET NUK SHUHEN KURRË . . . . .</b>	<b>19</b>
Oskar Uajld: PRINCI I LUMTUR . . . . .	20
Ismail Kadare: RA SI YLLI, PO S'U SHUA . . . . .	21
Azem Shkreli: BJESHKA . . . . .	22
Grigor Vitez: KËNGË PËR TË GJITHË FËMIJËT E BOTËS . . . . .	23
Popullore: MBRETI DHE PLAKU . . . . .	24
<b>KREU IV: GURI I RËNDË PESHON NË VEND TË VET . . . . .</b>	<b>25</b>
Esad Mekuli: POROSIA E NANËS . . . . .	26
Edmond de Amiçis: UDHA . . . . .	27
Dritëro Agolli: TUNGJATJETA . . . . .	28
Asllan Bisha: NATA E PARË NË PESHKIM . . . . .	29
Rexhep Hoxha: DIMRAKEQI . . . . .	30
<b>KREU IV: NË KOPSHTINE E MAGJEPSUR . . . . .</b>	<b>31</b>
Arif Demolli: LUSHI NË KOPSHTIN E MAGJEPSUR . . . . .	32
Dushan Gjurishiq: MIRËMËNGJESI . . . . .	33
Ibrahim Braho: GËNJESHTRA DOLI NË SHESH . . . . .	34
TRURI ELEKTRONIK . . . . .	35
Vangjeli Çomora: E MIRA DHE E BUKURA NUK KANË FUND . . . . .	36
Xhevahir Spahiu: VERË . . . . .	37



# PARATHËNIE

## Përdorimi i librit të mësuesit

Hartimi i librit të mësuesit është një përvojë e re në fushë të teksteve shkollore në gjuhën shqipe në Malin e Zi. Në rastin konkret edhe për mua, autorin e këtij teksti është punë e parë në këtë fushë. Sidoqoftë synimi është që ky tekst që jetë sa më praktik për mësuesit/et që do ta përdorin konkretisht në zbatimin e planit dhe programit të lëndës së gjuhës shqipe e letërsisë për klasën e pestë të shkollës fillore nëntëvjeçare.

Rezultatet e të nxënës që duhet t'i arrijë nxënësi/ja kanë një vend të rëndësishëm, në këtë libër, pasi ky është një nga synimet themelore të tij. Duke u nisur nga parimi i zbatimit praktik të këtij teksti, kam pasur parasysh, sidomos tekstin mësimor. Është bërë një lidhje e natyrshme, midis veprimtarive të cilat duhet të bëjë nxënësi/ja- mësuesi/ja, që parashihen si nga libri i mësuesit por edhe nga libri i nxënësit. Në shumicën e rasteve këto lloje veprimtarish plotësojnë njëra-tjetrën, duke krijuar një harmoni për aq sa është e mundur në rastin konkret.

Në të njëjtën kohë, në librin e mësuesit është bërë përpjekje që të inkuadrohen veprime që duhet t'i bëjë nxënësi e mësuesi edhe në raport me lëndët e fushat e tjera të afërta me letërsinë si: filmi, arti figurativ, muzika etj. Përdorimi i të arriturave të teknologjisë si; interneti, rrjetet sociale, përkatësisht përdorimi efikas i kompjuterit, sidomos, janë inkuadruar në këtë tekst në mënyrë të natyrshme, duke pasur parasysh edhe faktin se tashmë fëmijët e kësaj moshe kanë përdorim të përditshëm dhe dinamik të këtyre mjeteve të teknologjisë.

## Synimet themelore të librit të mësuesit

Mënyra e organizimit të orës së mësimi, prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura nga nxënësi si dhe vlerësimi janë disa nga synimet që duhet të arrihen brenda realizimit me sukses të një ore mësimore. Si rrjedhim, në librin e mësuesit ato kanë vend kryesor. Rubrikat: qëllimi i mësimi dhe mjetet mësimore për njësitë përkatëse mësimore janë hartuar, gjithashtu me parimin që të jenë sa më të zbatueshme. Kur kam hartuar qëllimin e mësimi për njësitë përkatëse të planifikuara, kam pasur parasysh që synimi i mësimi të përmbushë rezultatet e arritura të nxënësve jo vetëm aspektin përmbajtjesor, përkatësisht kuptimor të njësisë mësimore, por edhe të formës, ndërtimit strukturor të tekstit.

Kurse, sa u përket mjeteve mësimore, përkatësisht burimeve përveç tekstit mësimor që është doracak mësimor, herë-herë parashihen të përdoren edhe veprat e zgjedhura të autorëve përkatës. Në kuadër të mjeteve mësimore janë përfshirë edhe burime të ndryshme nga interneti sidomos rrjeti i fuqishëm youtupe në të cilën me lehtësi mund të gjenden video-materiale në formë filmash të ndryshëm, pjesëve teatrale apo këngësh të veprave e autorëve të llojllojshëm të paraparë me programin e lëndës.

Sigurisht, që libri i mësuesit, përkatësisht qëllimet e mësimoreve, mjetet mësimore dhe veprimtaritë e mësuesit-es janë propozime, përkatësisht mundësi të dhëna në formë sugjerimesh që ju mund t'i keni parasysh. Por sigurisht kurdo që është e nevojshme dhe në çdo situatë kur ju e shihni të domosdoshme dhe keni ide të tjera, mund të organizoni njësinë mësimore, duke bërë ndryshimet, përshtatjet, plotësimet tuaja, duke marrë ide edhe nga nxënësit.

Punë të mbarë!

Autori



## KREU I: ËMBËL DHE BUKUR NË GJUHËN SHQIPE

## BILBILI

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- fillimisht në formë të përmbledhur diskutojnë për biografinë e poetit Naim Frashëri;
- me dialog zbulojnë gradualisht veprat kryesore të Naim Frashërit;
- lexojnë secili për vete poezinë "Bilbili", përkatësisht mësojnë ta recitojnë;
- pas leximit të çdo strofe, nxënësit shprehin mendimet e tyre duke përcaktuar veçoritë letrare e artistike të saj;
- nxënësit duke u bazuar në poezinë përkatëse flasin për ndryshimin e natyrës në pranverë, përkatësisht në muajin maj;
- nxënësit diskutojnë për fjalët që mund të mos i kuptojnë, duke i sqaruar ato dhe vënë në dukje se gjuha nuk shkruhet njëloj në kohë dhe nga poetë të ndryshëm;
- duke përdorur metodën individuale, bën përsëritjen e mësimin në formën pyetje-përgjigje.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja-ndan nxënësit në tri grupe: grupi i parë është grupi i bilbilave, grupi i dytë i dallëndysheve dhe grupi i tretë i kanarinave. Secili nga grupet flet për zogjtë përkatës. Duke u bazuar në gjallërimin e zogjve në pranverë: si model merret bilbili në poezinë me të njëjtin titull të N. Frashërit;
- duke u bazuar në njësinë mësimore përkatëse sesi është trajtuar në tekstin mësimor, u jep për detyrë nxënësve të gjejnë figurën letrare të personifikimit dhe gjejnë ndonjë shembull të tij në poezi.
- duke përdorur metodën individuale bën përsëritjen e mësimin në formën pyetje-përgjigje.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të njohin aspektin përmbajtjesor dhe strukturor në poezinë "Bilbili", shkruar nga Naim Frashëri.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri "Lulet e verës" nga Naim Frashëri.



Ndre Mjeda

## GJUHA SHQIPE

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- shfletojnë përmbledhjen me poezi "Juvenilja" të Ndre Mjedës, duke përmendur poemat e tij kryesore që ka shkruar dhe gjejnë në mënyrë të natyrshme poezinë "Gjuha shqipe";
- nxënësit bashkëbisedojnë për vlerat e gjuhës (ëve), konkretisht për gjuhën amtare shqipe;
- diskutojnë për arsyen se pse poetë të ndryshëm shqiptarë, gjuhës shqipe i kanë kushtuar poezi;
- një nxënës/e reciton poezinë "Gjuha shqipe" për ta shijuar atë si tekst;
- gjejnë vargjet e caktuara të cilat vlerësojnë gjuhët e tjera, por veçojnë gjuhën shqipe;
- flasin për veçoritë e përbashkëta të një populli, në këtë rast të shqiptarëve, siç janë: gjuha, historia, kombi, përkatësisht pasojat kur ekzistojnë përçarje, sa u përket këtyre karakteristikave bashkuese.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- motivon nxënësit për të zhvilluar punën në grupe, duke u dhënë për detyrë njërit grup të gjejnë figurën stilistike të krahasimit (e ilustronjë me shembuj konkretë) dhe grupit tjetër të diskutojnë për gjuhën që përdor poeti në këtë poezi;
- bashkëbisedon me nxënës, duke u nisur nga poezia konkrete, se letërsia e traditës është shkruar në variante të ndryshme letrare: dialektore, standarde, të folme, duke përfunduar se gjuha letrare është më e gjerë se ajo standarde.

### Arritjet e të nxënësit:

- do të jenë në gjendje të njohin veçoritë letrare, stilistike dhe figurative të poezisë "Gjuha shqipe" të Ndre Mjedës.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, përmbledhja me poezi "Juvenilja" e Ndre Mjedës, interneti (poezia "Gjuha shqipe" e recituar nga ndonjë aktor).

## MOLLËKUQJA E FËMIJËRISË

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- flasin, duke sjellë përvojën vetjake për moshën e fëmijërisë si dhe për ndonjë ngjarje që u ka ndodhur në të shkuarën, kur kanë qenë më të vegjël;
- lexojnë strofën e parë të poezisë, duke u përpjekur që të vënë në dukje se cila është dëshira e fëmijës dhe cila porosia e nënës;
- flasin për përvojat e tyre personale, si kanë vepruar ata në rastet e ngjashme;
- lexojnë në heshtje strofën e parë dhe të dytë të poezisë, duke u përpjekur të përgjigjen në pyetjen se për çfarë fluturimi është fjala, për fluturimin imagjinar apo real;
- diskutojnë se ku, me kë dhe si do të kishin dëshirë të fluturonin po të ishte e mundur;
- shprehin mendimin se ç'kuptojnë me mollëkuqen e fëmijërisë, pse kujtohet ajo me shumë mall.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja u kërkon nxënësve të gjejnë dhe të ndjekin në youtube këngë për moshën e fëmijërisë dhe këngën "Plak me merak";
- duke u nisur edhe nga strofa e fundit e poezisë dhe këngëve të ndjekura kërkon që nxënësit të gjejnë dallimet dhe anët e përbashkëta midis moshës së fëmijërisë dhe pleqërisë.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të dallojnë dy motivet themelore të poezisë "Mollëkuqja e fëmijërisë": motivin e fëmijërisë dhe atë të pleqërisë.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, këngë me tematikë për moshën e fëmijërisë dhe kënga "Plak me merak" në youtube.

*Sami Frashëri*

## **SOLONI DHE KRISUA**

### **Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:**

- flasin sesi letërsia nuk përbëhet vetëm nga jeta e fantazuar, por edhe nga ngjarje që ndodhin në të vërtetë;
- diskutojnë se herë-herë letërsia i ka të theksuar a elementet didaktike, domethënë, ajo jep edhe porosi;
- zgjedhin nga një fjalë të urtë nga Sami Frashëri dhe arsyetojnë se pse u pëlqen më së shumti;
- bëjnë pyetje e përgjigje për temën se pse mjetet materiale nuk duhet të bëhen synim në jetë, por të trajtohen si mjet për jetë më të mirë;
- përcaktojnë se cila është ndjenja themelore që mbizotëron në këtë poezi siç janë: melankolia, malli, trishtimi, vuajtja.

### **Metodat dhe teknikat e realizimit:**

- mësues-i/ja përdor teknikën stuhi mendimesh, duke bërë fillimisht vetë pyetjet, pastaj nxënësit pyesin njëri-tjetrin për format e fantazuara dhe didaktike të letërsisë, përkatësisht arsyetojnë pse një pjesë përkrahin Solonin, kurse të tjerët Krison;
- duke u mbështetur në mesazhin e rrëfimit kërkon të arsyetojnë (pasi janë përgatitur) se pse pasuria është e rëndësishme dhe të jep mundësi të realizosh shumë gjëra në jetë;
- duke u mbështetur në mesazhin e rrëfimit përgjigjen se pse, megjithatë pasuria nuk është gjithçka, në krahasim me dashurinë, shëndetin, harmoninë familjare.

### **Arritjet e të nxënit:**

- do të jenë në gjendje të mësojnë përmbajtjen themelore të tekstit, përkatësisht mesazhin (porosinë) e tij, duke vënë në dukje se letërsia herë-herë është edhe këshilluese.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, vepra e Sami Frashërit.

## ROZAFATI

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- në tekstin mësimor të mësimit përkatës lexojnë pjesën për baladën;
- diskutojnë për veçoritë kryesore të baladave;
- ndahen në tri grupe dhe bashkërendojnë veprimet për të prezantuar punën e grupeve përkatëse;
- anëtarët e grupit të parë bëjnë paraqitjen e tekstit "Rozafati" të Mitrush Kutelit, duke u bazuar në pyetjet themelore që janë shtruar në tekstin mësimor. Përgjigjet ilustrohen me fragmentet gjegjëse nga teksti;
- anëtarët e grupit të dytë lexojnë fragmente të baladës popullore që mund t'i gjejnë paraprakisht, duke vërejtur veçantitë dhe të përbashkëtat me tekstin përkatës të shkruar nga Mitrush Kuteli;
- anëtarët e grupit të tretë realizojnë prezantimin e tyre duke argumentuar mendimet me fragmente nga filmi "Muri i gjallë", me përqendrim të veçantë në ndryshimet që janë bërë në film në krahasim me tekstet e përmendura, atë popullor dhe autorial.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja ndan në tri grupe: grupi i parë quhet "Rozafati" sipas Kutelit, grupi i dytë e ka emrin "Rozafati", baladë popullore dhe grupi i tretë është emërtuar filmi "Muri i gjallë", sipas filmit përkatës shqiptar.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të dallojnë vlerat ideo-letrare të baladës "Rozafati" nga Mitrush Kuteli, përkatësisht të këtij lloji letrar epiko-lirik.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, teksti i baladës përkatëse popullore, filmi "Muri i gjallë", realizuar me motivet e kësaj balade.

## KREU II: LIBRI, USHQIM I SHPIRTIT

Filip Shiroka

## LULES QI M'DËRGOI NANA E EME

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- lexojnë disa herë me vëmendje poezinë përkatëse;
- ndahen në tri grupe: A, B, C.
- grupi A flet dhe reciton vargjet që u kushtohen dashurisë për nënën, përkatësisht mallit ndaj saj;
- grupi B përcakton, reciton vargjet që u kushtohen dashurisë, mallit për atdheun, vendlindjen, përkatësisht mallit për qytetin e lindjes, Shkodrën;
- grupi C zbërthen kuptimin e fjalës çelës në këtë poezi që është lulja, duke u përqendruar në shumëkuptimësinë e saj: në poezinë përkatëse dhe në kuptimet e tjera;
- shprehin mendimet e tyre pse lulja është e vyshkur (e vyshkun);
- përgjigjen se cilat kanë qenë arsyet kryesore që një pjesë e madhe e shkrimtarëve të letërsisë shqipe në të kaluarën kanë qenë të detyruar të jetojnë në vende të huaja- japin mendimet e tyre për titullin e përmbledhjes së vetme të autorit "Zani i zemrës".

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja përdor teknikën e punës në grupe. Grupi A flet për dashurinë ndaj nënës, grupi B reciton vargjet që i kushtohen mallit për atdheun dhe grupi C analizon fjalën çelës në poezi që është lulja.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të përcaktojnë motivet themelore të poezisë që janë ai i mallit për atdheun, për vendlindjen, njerëzit e afërt si edhe simbolin si figurë stilistike.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, vëllimi poetik "Zani i zemrës".

## VJESHTA

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- ndahen në çifte sipas dëshirës së tyre;
- sipas dëshirës pikturojnë vjeshtën dhe gjejnë këngë në youtube kushtuar kësaj stine ose që përshkruajnë natyrën;
- sipas dëshirës pikturojnë punët e njeriut që bën në natyrë në stinën e vjeshtës dhe gjejnë ndonjë këngë për fëmijë e cila pasqyron punët në këtë stinë;
- shumica e çifteve diskutojnë për ndjenjën e trishtimit, por edhe bukuritë e kësaj stine;
- flasin për simbolikën e pjekjes së pemëve në vjeshtë;
- japin mendimin për kultin e punës, duke u bazuar në vargun “Vetëm me punë të rrojmë”;
- zbërthejnë kuptimin themelor të thënies së poetit Naim Frashëri: “Punë, punë natë e ditë, që të shohim pakëz dritë”, që përputhen në aspektin e domethënies me vargjet e cituara më lart të Asdrenit.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja ndan nxënësit në çifte; çiftet sipas dëshirës analizojnë pjesën e parë të poezisë që përshkruan peizazhin e vjeshtës dhe punët e veprimtaritë që bën njeriu në vjeshtë.

### Arritjet e të nxënësit:

- do të jenë në gjendje të dallojnë strukturën kuptimore dhe ndërtimore të poezisë “Vjeshta”;
- i kanë të qarta motivet themelore që trajtohen në vjershë.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor dhe materiale nga interneti: këngë dhe vizatime kushtuar vjeshtës.

## BORA

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- fillimisht lexojnë tekstin, duke shënuar në një fletë të ndarë në mes në formë vertikale; në një rënë anë shënojnë ndonjë citat nga teksti, kurse në anën tjetër mbresat e tyre;
- ndajnë tekstin në katër pjesë: parapërgatitja për rënien e borës, rënia e borës, veprimtaritë e zogjve kur bie borë, veprimtaritë e fëmijëve kur bie borë;
- mbi bazën e këtyre temave klasa ndahet në katër grupe: secili grup shpreh me shkrim ose edhe përmes vizatimit situatën përkatëse;
- hetojnë bukurinë e përdorimit të gjuhës në këtë skicë, duke gjetur fjalë e sintagma të veçanta në këtë tekst;
- gjejnë disa sinonime në tekst, duke iu referuar tekstit mësimor se çfarë janë sinonimet;
- grupet prezantojnë punën e tyre në formë të përmbledhur.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja kombinon dy teknika: ditarin dypjesësh dhe punën në grupe;
- gjatë leximit me kujdes të skicës nxënësit në gjysmën e majtë shënojnë pjesët e zgjedhura, përkatësisht citatet, kurse në anën tjetër mbresat e tyre;
- mbi bazën e temave klasën e ndan në katër grupe, duke përcaktuar që secili grup të flasë, përkatësisht ta shprehë me shkrim ose edhe përmes vizatimit, situatën përkatëse;

### Arritjet e të nxënësve:

- do të jenë në gjendje të mësojnë strukturën përmbajtjesore dhe ndërtimore të skicës "Bora";
- janë aftësuar të shkruajnë një tekst në formë hartimi ose të realizojnë një pikturë që ka për temë borën.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, muzikë argëtimi sipas moshës në youtube, e cila shoqërohet me peizazhin e borës.



## BENI ECËN VETË

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- ndahen në çifte. Afërsisht gjysma e çifteve përgatisin analizën e fragmenteve të romanit “Beni ecën vetë”, kurse gjysma tjetër përgatisin analizën e filmit me të njëjtin titull. Paraprakisht nxënësit e kanë shikuar këtë film në internet;
- diskutojnë për ndryshimin e personazhit të Benit nga një fëmijë i varur tërësisht në një fëmijë që fillon të pavarësohet;
- dallojnë sesi bëhet transformimi i Benit gjatë qëndrimit në fshat;
- bëjnë zberthimin e titullit të këtij romani në disa kuptime;
- lexojnë për nëntekstin, përkatësisht për kuptimin e parë dhe të dytë të tekstit letrar në tekstin mësimor;
- nga kompjuteri, përkatësisht mjetet e tjera teknike shikojnë në klasë pjesë nga filmi.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja ndan klasën në çifte;
- afërsisht gjysma e çifteve përgatisin analizën e fragmenteve të romanit “Beni ecën vetë”;
- pjesës tjetër të çifteve u jep për detyrë të përgatisin analizën e filmit me të njëjtin titull. Paraprakisht nxënësve u është sugjeruar ta gjejnë dhe shikojnë këtë film në internet.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të përcaktojnë idenë, temën dhe nëntekstin e këtij fragmenti të romanit “Beni ecën vetë”;
- do të jenë në gjendje të kuptojnë mesazhin kryesor se pavarësia në jetë është një nga parimet themelore që duhet të ndërtohet qysh në fëmijërinë e hershme.

**Mjetet mësimore:** Teksti mësimor, filmi “Beni ecën vetë”.

Huan Leopold Davi

## ME GJITHË SHPIRT

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- lexojnë disa herë vjershën "Me gjithë shpirt" dhe ndahen në dy grupe;
- grupi i parë gjen në poezi vargjet që shprehin përkrahjen emocionale për atë që ka nevojë, kurse grupi i dytë gjen në poezi vargjet që shprehin mbështetjen materiale për atë që ka nevojë;
- përfaqësuesit e grupeve përkatëse, ndihmat e përmendura i konkretizojnë me fjalët përkatëse çelësa që përmbajnë fjalët e përkrahjes konkrete;
- secili nga grupet zbërthen kuptimin e titullit të kësaj vjershe që përsëritet edhe në kuadër të vargut të fundit;
- sjellin shembujt e tyre sesi sillen ata ndaj njerëzve në nevojë;
- flasin për ndonjë veprimtari humanitare që është zhvilluar në mjedisin e tyre ose kanë lexuar për të, ose e kanë parë në ndonjë kanal televiziv.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja ndan nxënësit në dy grupe; këshillon nxënësit e grupit të parë që të gjejnë në poezi vargjet që shprehin përkrahjen emocionale për atë që ka nevojë, këshillon nxënësit e grupit të dytë që të gjejnë në poezi vargjet që shprehin përkrahjen materiale për atë që ka nevojë.
- u jep detyrë shtëpie që të hartojnë temën: "Të ndihmohet të tjerët në nevojë dhe kënaqësi".

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të njohin dhe mësojnë për varfërinë, si dukuri në botë;
- do të jenë në gjendje të krijojnë ndjeshmërinë njerëzore që shtresat në nevojë duhet të ndihmohen dhe të përkrahen.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, ndonjë film dokumentar për Nënë Terezën, si simbol i humanizmit.

## KREU III: YJET NUK SHUHEN KURRË

Oskar Uajld

## PRINCI I LUMTUR

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- ndahen në tri grupe;
- emërtojnë grupet sipas tri ndjenjave kryesore emocionale që dalin në tekstin "Princi i lumtur": grupi i mirësisë, grupi i dashurisë dhe grupi i flijimit (i sakrificës);
- secili grup gjen në tekst pjesët që shprehin ndjenjat përkatëse dhe sqarojnë kuptimet e këtyre fragmenteve, duke folur sesi shprehen tri ndjenjat e përmendura;
- gjejnë në internet poezinë e Naim Frashërit "Fjalët e qiririt" dhe bëjnë krahasimin midis dy teksteve letrare sa u përket shprehjes së mirësisë, dashurisë e sakrificës;
- flasin për personalitete humaniste, sidomos për atë të nobelistes shqiptare Nënë Tereza, duke shquar veprimtarinë e saj humanitare për të ndihmuar të varfrit e botës.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- ndan nxënësit në tri grupe, duke i emërtuar ato sipas tri ndjenjave kryesore emocionale që dalin në tekstin "Princi i lumtur": grupi i mirësisë, grupi i dashurisë dhe grupi i flijimit (sakrificës);
- u jep të punojnë detyrë shtëpie temën: "T'ua përkushtosh nevojtarëve jetën e vet", bazuar në jetën dhe veprën e Nënë Terezës".

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të dallojnë rëndësinë e ndjenjave njerëzore siç janë: mirësia, dashuria dhe flijimi, përkatësisht rëndësinë e përkushtimit njerëzor për të mirat e njerëzve të tjerë.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, poezia "Fjalët e qiririt" nga Naim Frashëri, të dhëna për jetën dhe veprën e nobelistes Nënë Tereza.

Ismail Kadare

## RA SI YLLI, PO S'U SHUA

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- lexojnë disa herë fragmentin e poemës të përfshirë në tekstin mësimor;
- secili individualisht dhe në formë të pavarur ndan poemën në nëntema përbërëse;
- pas emërimit të secilës nëntemë flasin për to, duke gjetur vargjet adekuate dhe duke i recituar;
- shkruajnë pjesët përbërëse të tekstit, duke i emërtuar ato, sipas mendimit të tyre;
- përcaktojnë nëntemat, të cilat mund të jenë: rezistenca e shqiptarëve para se turqit të hyjnë në kështjellë, akti i hedhjes së princeshës me foshnjën nga kalaja, reagimi i ushtarëve turq, reagimi i natyrës;
- gjejnë figurat stilistike në tekstin e poemës si: krahasimin dhe metaforën.
- analizojnë vargjet: "ra si yll, po s'u shua", "po a zihet ylli vallë?".

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- përdor metodën individuale, duke motivuar secilin nxënës për të ndarë poemën në nëntema: rezistenca e shqiptarëve para se turqit të hyjnë në kështjellë, akti i hedhjes së princeshës me foshnjën nga kalaja, reagimi i ushtarëve turq, reagimi i natyrës.

### Arritjet e të nxënësve:

- do të jenë në gjendje të përcaktojnë strukturën përmbajtjesore dhe ndërtimore të poemës;
- do të dinë motivet e rezistencës dhe të flijimit në këtë tekst letrar.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, ndonjë dokumentar për kalanë e Gjirokastrës, marrë nga interneti.

Azem Shkreli

## **BJESHKA**

### **Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:**

- përshkruajnë sesi është natyra në bjeshkë, duke pasuar parasysh përvojën e tyre ose atë që dinë për këtë mjedis;
- në video-projektor, në bazë të mundësive teknike, shohin ndonjë video-reportazh të shkurtër, mundësisht për bjeshkët e Rugovës që gjenden në Kosovë;
- secili për vete lexon disa herë poezinë "Bjeshka";
- gjejnë fjalët e panjohura në poezi dhe shohin sqarimet për to në tekstin mësimor;
- lexojnë pjesën gjuha e tekstit letrar që gjendet në njësinë mësimore "Bjeshka" nga Azem Shkreli" në tekstin mësimor;
- gjejnë specifikat e gjuhës së tekstit mësimor në poezi duke dalluar figurshmërinë, stilin, por edhe variantin gjuhësor përkatës.

### **Metodat dhe teknikat e realizimit:**

- mësues-i/ja, për të realizuar mësimin, kombinon metodën frontale dhe individuale dhe motivon nxënësit për të trajtuar poezinë përkatëse në aspektin figurativ, përkatësisht strukturor.

### **Arritjet e të nxënit:**

- do të jenë në gjendje të flasin për bukurinë dhe ashpërsinë e mjedisit, shprehur në poezi, si dhe funksionin e gjuhës së tekstit letrar.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, përmbledhje e zgjedhur me poezi të Azem Shkrelit.

Grigor Vitez

## KËNGË PËR TË GJITHË FËMIJËT E BOTËS

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- lexojnë disa herë me vëmendje poezinë përkatëse;
- lexojnë për të drejtat dhe liritë e fëmijëve, të cilat mund të gjenden në google me ndihmën e internetit ose ato që i kanë gjetur më përpara;
- pas leximit të poezisë, diskutojnë në çifte për poezinë, duke analizuar shenjat që janë vendosur pas vargjeve, përkatësisht pas strofave;
- pas leximit për të drejtat dhe liritë e fëmijëve diskutojnë në çifte, duke analizuar shenjat që janë vendosur pas tyre;
- krijojnë tabelën e insertit për poezinë dhe listën e të drejtave dhe të lirive të njeriut;
- bëhet prezantimi i punës së disa çifteve sipas dëshirës;
- çiftet e tjera shprehen për punën e prezantuar të çifteve.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja përdor metodën INSERT që është sistemi ndërveprues i shënjimit për të menduarit dhe leximin efektiv.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje për të arritur në përfundimin se fëmijët në botë, pa marrë parasysh përkatësitë e ndryshme, duhet të kenë liri dhe të drejta të barabarta.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, lista e të drejtave të fëmijëve sipas UNICEF-it.

Popullore

## MBRETI DHE PLAKU

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- një nga nxënësit lexon tregimin popullore, para klasës, kurse të tjerët dëgjojnë me vëmendje;
- lexojnë edhe njëherë tregimin, duke nënvizuar pjesët e dialogut figurativ që mbreti zhvillon me plakun;
- lexojnë në tekstin mësimor njësinë mësimore përkatëse, pjesën analizë teksti;
- analizojnë secilën nga fjalët, përkatësisht sintagmat në të cilat del përdorimi figurativ, alegorik i gjuhës;
- analizojnë personazhin e plakut;
- analizojnë personazhin e mbretit;
- zbërthejnë kuptimet e fjalive: "plaku punon dheun", "mbreti sundon dheun";
- përpiqen për të gjetur arsyen se pse e shpërblen mbreti plakun;
- japin përgjigjen pse të mençurit i quan dy desh.

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** duke përdorur metodat individuale e frontale, angazhon nxënësit për të analizuar e zbërthyer tekstin popullore.

### Arritjet e të nxënit:

- do të dinë të gjejnë porosinë dhe gjuhën figurative të këtij rrëfimi, përkatësisht përdorimin e fjalëve me nënkuptime.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor.



## **KREU IV: GURI I RËNDË PESHON NË VEND TË VET**

Esad Mekuli

## **POROSIA E NANËS**

### **Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:**

- lexojnë secili për vete disa herë poezinë,
- ndajnë poezinë në tri pjesë, të cilat mund të jenë: lutjet e nënës, dheu i huaj dhe pasojat e shkuarjes në mërgim;
- ndahen në tri grupe, duke trajtuar secili grup një nga pjesët e poezisë;
- grupet gjejnë arsyet e shpërnguljes së shqiptarëve, si dukuri e vazhdueshme;
- gjithashtu arsyetojnë se pse u bën be nëna djemve të saj;
- sipas renditjes logjike bëhet prezantimi i punëve të grupeve;
- nga një përfaqësues i grupeve jep mendimet për prezantimet e grupeve të tjera;
- gjejnë në youtube këngë të ndryshme të cilat kanë për motiv mërgimin dhe i shikojnë e dëgjojnë së bashku.

### **Metodat dhe teknikat e realizimit:**

- ndan në tri grupe klasën, duke folur secili grup për pjesën e tij të poezisë në formë të përmbledhur;
- përdor edhe metodën individuale, duke motivuar nxënësit për të shprehur mendimet e tyre për masat që duhen marrë me qëllim që dukuria e shpërnguljes të zvogëlohet.

### **Arritjet e të nxënit:**

- do të jenë në gjendje të identifikojnë motivin themelor të kësaj poezie që është mërgimi dhe pasojat e kësaj dukurie, sidomos të shqiptarët.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, këngë me motive të mërgimit.

## UDHA

### **Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:**

- lexojnë para klasës tekstin “Udha” dhe pastaj ndahen në dy grupe: A e B;
- duke iu referuar tekstit, por edhe rregullave të sjelljes në mjediset publike e urbane, por edhe rurale, grupet përkatëse A e B hartojnë listën e rregullave sesi duhet të sillen në rrugë, përkatësisht në mjediset publike;
- të dy grupet hartojnë listën e rregullave të sjelljes në fletë të mëdha (në karton) që më vonë do t’i vendosin në muret e klasës;
- grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre, duke lexuar listën përkatëse e komentuar atë;
- lexojnë në tekstin mësimor pjesën nga njësia mësimore përkatëse: mirësjellje, qytetari dhe atdhetari;
- përfaqësuesit e grupeve në formë të përmbledhur flasin për vlerat e mirësjelljes, të qytetarisë dhe të atdhetarisë.

### **Metodat dhe teknikat e realizimit:**

- ndan klasën në dy grupe: A e B;
- duke iu referuar tekstit, por edhe rregullave të sjelljes në mjediset publike, urbane, por edhe rurale, mësues-i/ja kërkon nga anëtarët e grupeve A e B që të hartojnë listën e rregullave sesi duhet të sillen në rrugë, çfarë duhet të bëjnë në mjediset publike.

### **Arritjet e të nxëniet:**

- do të jenë në gjendje të flasin për porositë e tekstit “Udha” se sjellja në rrugë, përkatësisht në mjediset publike është e rëndësishme të bazohet në rregullat e mirësjelljes, ndihmës, humanizmit, qytetarisë etj.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, një doracak i edukatës qytetare, për sjelljen në mjediset publike.

Dritëro Agolli

## TUNGJATJETA

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- lexojnë individualisht poezinë "Tungjatjeta";
- bëjnë përshkrimin e dukjes së nënës, që del në poezi, duke e konkretizuar me vargjet përkatëse;
- diskutojnë për marrëdhëniet që poeti, heroi lirik i ka me nënën e tij, duke zbërthyer edhe kuptimin e titullit të poezisë "Tungjatjeta";
- sqarojnë vargjet: "flokëbardha ime moj";
- analizojnë strofën e fundit të poezisë: "Po në ballin tënd të qetë,/ Flokëbardha ime moj/, Shoh të shkruara dy jetë:/ Një që erdhi, një që shko!"/.
- me shkrim ose me gojë, në bazë të dëshirës secili(a) nxënës(e) përshkruan portretin e nënës, atë shpirtëror; karakterin e saj, por edhe pamjen fizike;
- arsyetojnë pse nëna për secilin fëmijë është person shumë i rëndësishëm;
- flasin për dashurinë ndaj prindërve, posaçërisht ndaj nënës, duke pasur parasysht përvojën personale.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- përdor metodën individuale, duke përkrahur e motivuar nxënësit që të krahasojnë portretin e nënës që del në poezi, me nënën e tyre;
- kombinon edhe metodën frontale, duke aktivizuar tërë klasën për të diskutuar për motivin e dashurisë ndaj prindërve, veçanërisht ndaj nënës.

### Arritjet e të nxënit:

- do të dinë të përcaktojnë motivin kryesor të kësaj poezie që është dashuria ndaj nënës, pa marrë parasysht moshën e saj.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, përmbledhje e zgjedhur me poezi nga Dritëro Agolli.

Asllan Bisha

## NATA E PARË NË PESHKIM

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- lexojnë me vëmendje tregimin "Nata e parë në peshkim";
- përqendrohen në personazhet e këtij tregimi, duke i ndarë sipas moshave; gjyshi, xha Lami dhe fëmijët;
- krijojnë tri grupe: grupi i parë analizon personazhin e gjyshit, i dyti të xha Lamit dhe i treti të fëmijëve;
- diskutojnë për anët e përbashkëta të këtyre personazheve dhe ato që i dallojnë;
- flasin për përvojat e tyre individuale të peshkimit, apo rrëfimet e vërteta që i kanë dëgjuar nga të tjerët;
- përqendrohen në fshehtësitë e peshkimit, duke u bazuar në tregimin përkatës, por edhe në ndonjë përvojë individuale;
- grupet përkatëse bëjnë prezantimin e punëve të tyre;

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- mësues-i/ja ndan klasën në tri grupe, duke u sugjeruar që të flasin për veçoritë e personazheve, për kënaqësitë e peshkimit bazuar në tregimin përkatës, por edhe për ndonjë përvojë individuale të vetë nxënësve;
- u jep të punojnë detyrë shtëpie temën: "Një ditë peshkimi me babanë tim", duke i këshilluar se hartimi i detyrës mund të gërshetohet me rrëfime të vërteta ose të krijuara.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të përshkruajnë trajtimin e temës së peshkimit dhe kureshtjen e fëmijëve për këtë profesion.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i Asllan Bishës: "Net peshkimi".

Rexhep Hoxha

## DIMRAKEQI

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- lexojnë disa herë vjershën përkatëse, sidomos pjesën, përfundimi i dimrit;
- japin mendimin e tyre pse dimri quhet dimrakeqi;
- shprehin mendimet për ndryshimet e natyrës me përfundimin e dimrit dhe fillimin e pranverës;
- flasin për ndryshimet të njerëzimit me ardhjen e pranverës;
- diskutojnë për punët që fillojnë të bëhen në bujqësi sidomos me përfundimin e dimrit;
- ndajnë fjalën dimrakeqi në dy pjesë, duke treguar sesi është formuar kjo fjalë;
- mësojnë se çfarë janë fjalët e përbëra, duke i shoqëruar me shembuj të ndryshëm;
- në tekstin mësimor lexojnë rubrikën fjalët e panjohura nga kjo njësi mësimore, duke u njohur me kuptimet e tyre.

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** përdor teknikën e stuhisë së mendimeve e cila bazohet në pyetje-përgjigje që u bën mësuesi nxënësve, përkatësisht nxënësit i bëjnë njëri-tjetrit.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të njohin strukturën përmbajtjesore dhe ndërtimore të vjershës.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, përmbledhje e zgjedhur me poezi nga Rexhep Hoxha.

## KREU V: NË KOPSHTIN E MAGJEPSUR

Arif Demolli

## LUSHI NË KOPSHTIN E MAGJEPSUR

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- nxënësit ndahen në dy grupe: I dhe II;
- grupi I lexon dhe analizon me vëmendje fragmentin e parë të tregimit: "Magjepsja e kopshtit të Lushit";
- grupi II lexon dhe analizon me vëmendje fragmentin e dytë të tregimit: "Përdorimi i shkopit të tretë magjik";
- anëtarët e grupit I përqendrohen në dëshirën e personazhit kryesor Lushit për pasuri, përkatësisht të mbajnë qëndrim për lakminë, si ves;
- anëtarët e grupit II gjejnë fragmentin, në të cilin magjistari i tërheq vërejtjen Lushit se në të ardhmen do të shihet se sa do të zgjasë lumturia;
- grupi I bën prezantimin e punës;
- grupi II bën prezantimin e punës;
- të dy grupet harmonizojnë mendimet e tyre se cili është mesazhi themelor i këtyre dy fragmenteve të tregimit përkatës.

### Metodat dhe teknikat e realizimit:

- përdor punën në grupe bazuar në diskutimin, harmonizimin dhe përfundimet e mendimeve;
- u jep nxënësve detyrë shtëpie me temën; "Nuk është gjithçka pasuria".

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të sqarojnë domethënien e këtyre fragmenteve të tregimit përkatës, se pasuria dhe lumturia nuk janë të harmonizuara gjithnjë;
- duke pasur parasysh modelin e personazhit kryesor të këtij tregimi, arrijnë në përfundimin se lakmia për pasuri të madhe është e dëmshme.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, tregimi i plotë i Arif Demollit "Në kopshtin e magjepsur".



## MIRËMËNGJESI

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- flasin për fillimin e një dite të re, për mëngjesin, sidomos për rifillimin e jetës aktive të gjallesave, bazuar edhe në nisjen e poezisë përkatëse;
- gjejnë në poezi frymën e vullnetit dhe të dëshirës, përkatësisht optimizmit që përmbledhet përmes përshëndetjes, mirëmëngjesi;
- diskutojnë për nevojën e qëndrimit pozitiv ndaj njerëzve, dukurive dhe problemeve, gjithmonë duke besuar se ka një zgjidhje;
- gjejnë në poezi pjesët që u kushtohen vendlindjes, duke u përqendruar në bukuritë e saj dhe lidhjes shpirtërore me të;
- sjellin përvojën vetjake për vendlindjen e tyre, duke shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre për vendin ku kanë lindur;
- gjejnë vargjet në të cilat përmenden tri gjallesat siç janë: dallëndyshja, flutura dhe bleta, duke i motivuar nxënësit të shpjegojnë simbolikat e tyre.

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** mësues-i/ja bën kombinimin e formës frontale dhe individuale, duke u përpjekur të angazhojë tërë klasën.

### Arritjet e të nxënit:

- do të jenë në gjendje të flasin për rëndësinë e të menduarit dhe të vepruarit pozitiv në jetë;
- do të aftësohen të flasin për optimizmin e dëshirat e njeriut si për ringjalljen e bimëve dhe kafshëve, sidomos në fillim të ditës së re.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, këngë në youtube për optimizmin e njeriut, mëngjesin, ringjalljen e natyrës.

*Ibrahim Braho*

## **GËNJESHTRA DOLI NË SHESH**

### **Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:**

- në tekstin mësimor lexojnë pjesën: analizë teksti, duke mësuar thelbin e saj;
- shfaqin gatishmëri të lexojnë pjesën teatrale, duke i ndarë rolet e skeçit, sipas dëshirave dhe mundësive të tyre;
- nxënësit e tjerë lexojnë tekstin e skeçit;
- ushtrojnë tekstet e roleve dhe deklamojnë para klasës pjesën teatrale;
- ndahen në dy grupe: grupi I mbron qëndrimin e Petritit, kurse grupi II e kritikon atë;
- diskutojnë arsyet pse gënjeshtria është ves i keq dhe i dëmshëm, kurse e vërteta ka vlera të përhershme;
- sjellin përvojat vetjake të nxënësve për të vërtetat dhe gënjeshttrat eventuale;

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** mësues-i/ja përdor metodën individuale dhe diskutimet në grupe duke i kombinuar, në bazë të veprimtarive të nxënësve.

### **Arritjet e të nxënit:**

- do të jenë në gjendje të arrijnë në përfundimin se e vërteta ka vlera të mëdha dhe se duhet të jetë një nga parimet jetësore, kurse gënjeshtria zbulohet herët ose vonë;
- do të jenë në gjendje të dinë se duhet të zbatojnë në jetën e tyre, të treguarit e së vërtetës.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor.

## TRURI ELEKTRONIK

### **Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:**

- lexojnë tekstin përkatës, duke u përqendruar në përkufizimin e trurit elektronik dhe funksionet që ka ai;
- dëshmojnë njohjen e pjesëve të kompjuterit;
- nxënësit bëjnë veprime të ndryshme në kompjuter, duke kërkuar që ato t'i shoqërojnë edhe me fjalë;
- rikujtojnë njohuritë që i kanë marrë për trurin elektronik, kompjuterin në lëndën e arsimit teknik (informatikës);
- flasin për shkathtësitë që i kanë nxënësit në përdorimin e kompjuterëve dhe telefonave celularë;
- flasin haptas për kohën që e kalojnë sidomos duke përdorur celularët si dhe për rreziqet që vijnë nga përdorimi pa kriter i këtyre mjeteve teknologjike.

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** mësues-i/ja përdor teknikën e stuhisë së mendimeve, duke bërë pyetje e nxënësit duke u përgjigjur si dhe anasjelltas.

### **Arritjet e të nxënës:**

- do të jenë në gjendje të përcaktojnë rëndësinë dhe funksionin e trurit elektronik në jetën bashkëkohore, përkatësisht dobisë dhe dëmet e përdorimit të kompjuterëve.

**Mjetet mësimore:** teksti shkollor, kompjuteri.

## E MIRA DHE E BUKURA NUK KANË FUND

### Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:

- një nga nxënës-i/et që ka prirje për recitim, deklamon tregimin përpara klasës, kurse të tjerët dëgjojnë me vëmendje;
- konstatojnë sesi nis dialogu midis motrës dhe vëllait në këtë tregim, për rëndësinë e punës, për të arritur sukses në një veprimtari të caktuar;
- duke u bazuar në tregimin përkatës, në pjesën e kësaj njësie mësimore për punën në tekstin mësimor dhe në përvojën personale, diskutojnë për rëndësinë e punës, përpjekjeve, përkatësisht të mësuarit, për të arritur suksese në shkollë dhe gjetiu;
- diskutojnë se a kishte të drejtë personazhja kryesore, Jola që i ankohet babait të saj dhe është e mërzhitur se nuk ka marrë notën shkëlqyeshëm në hartim;
- flasin për mësimin që babai i jep bijës së tij sa i përket rëndësisë dhe këmbënguljes se vetëm me punë të vazhdueshme mund të arrihet sukcesi i vërtetë;
- diskutojnë për domethënien, përkatësisht dobinë e këtyre dy mendimeve në tregim e që duhet të jenë parime në jetën e çdokujt. Ja mendimet: "Puna e mirë, mbaje mend, bëhet me përpjekje. E mira dhe e bukura nuk kanë fund".

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** përdor metodën individuale dhe frontale në varësi të veprimtarive të nxënësve.

### Arritjet e të nxënit:

- nxënësit do të jenë në gjendje të precizojnë se puna dhe të mësuarit janë veprimet kryesore që duhen bërë për të pasur suksese në mësim, përkatësisht në jetë.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor.

Xhevahir Spahiu

## VERË

### **Veprimtaritë e NXËNËS-IT/ES:**

- lexojnë poezinë përkatëse, duke u përqendruar në mënyrën sesi e trajton poeti stinën e verës;
- flasin se çfarë përfundon me arritjen e verës, sa i përket fëmijëve dhe të rinjve;
- duke iu referuar edhe poezisë përkatëse, diskutojnë për kohën e pushimeve;
- flasin për planet konkrete se ku do t'i kalojnë pushimet e verës;
- në kuadër të kësaj njësie mësimore, lexojnë rubrikën sinonimet dhe antonimet në tekstin shkollor;
- gjejnë në poezi sinonime dhe antonime;
- duke pasur parasysh se poezia "Vera" është e lehtë për t'u mbajtur në mend: ka pak fjalë dhe numër të kufizuar strofash, nxënësit mësojnë së paku gjysmën e saj përmendësh.

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** kombinohen metodat: frontale dhe individuale duke i harmonizuar me veprimtaritë e nxënësve.

### **Arritjet e të nxënit:**

- do të jenë në gjendje të dinë strukturën përmbajtjesore dhe ndërtimore të kësaj poezie.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor.